



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 7995/3388/1187 Regjistri Themeltar  
Datë 09.10.2014 regjistrimi

Nr.1689 Vendimi  
Datë 15.06.2016

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

**GJYQTAR : Kastriot SELITA**  
**GJYQTARE : Bernina KONDI**  
**GJYQTARE : Altina NASUFI**

Asistuar nga sekretare gjyqësore Raimonda Aliaj, në Tiranë në datë 15.06.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr. 8155/3545/1329 regjistri themeltar, me palë ndërgjyqëse:

**PADITËS :** Shoqëria “Hamzaj”shpk, me qendër dhe adresë në Hoshtime-Vlorë, me administrator shtetasin Naim Hamzaj.

**TE PADITUR :** Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore.  
Drejtoria e Apelimit tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**OBJEKTI :** Kundërshtimi dhe shfuqizimi i shkresës “Njoftim vlerësimi tatimor për detyrimet” nr.15457 prot datë 31.12.2012 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.\nShfuqizimi i vendimit nr.1837/1 prot datë 07.01.2013 i Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 32,154,324 dhe 328 e vijues të Kodit të Procudures Civile. Neni 109 i ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; pika 80/3/e e udhëzimit nr 24/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dalë në zbatim të këtij ligji.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si ka shqyrtuar çështjen në themel me vendimin nr.1164, datë 06.05.2013 ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesë padisë.
- Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga data e nesërnja e shpalljes së vendimit.

Kundër këtij vendimi në datë 20.05.2013, ka paraqitur ankim pala paditëse duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e Vendimit datë 06.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranimin e kërkesë padisë:

- Ndodhemi përpara rrethanave të faktit që pikërisht organi administrative, i cili ka nxjerrë aktin e kundërshtuar, pranon (nëpërmjet mosparaqitjes së tij përpara Gjykatës faktin se urdhri i ditës nuk është nxjerrë asnjëherë nga ky organ, është e habitshme mënyra se si Gjykata konstaton të kundërtën duke u shprehur se ky Urdhër është administruar si provë në këtë gjykim.
- Pika 80/3/c e udhëzimit nr.24/2008 'Për procedurat tatimore në RSH' është shumë e qartë në sqarimin e procedurës që duhet ndjekur nga ana e inspektorëve tatimorë, të cilët ushtrojnë kontrollin dhe verifikimin në terren. Në këtë dispozitë është përcaktuar se keto verifikime kryhen pa njoftim paraprak, të personit të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit të dokumentit personal të verifikimit dhe urdhrin të ditës të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë rajonale të kontrollit për verifikime në vend.
- Pra urdhri i lëshuar nga drejtuesi i Drejtorisë së Kontrollit është akti nëpërmjet të cilit, inspektorët përkatës përligjin kontrollin tatimor të kryer për verifikimin në vend të shkeljeve. Një shkak i tillë sic është mungesa e këtij urdhri con në shkelje të procedurës së ushtrimit të kontrolleve tatimore në vend dhe në abuzim me detyrën. Fakti se urdhri i ditës nuk është lëshuar kurrë, përbën arsyen themelore të ngritjes së padisë nga ana jonë.

**Mbi ankimin e ushtruar nga pala paditëse, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin e saj nr.1028 datë 10.06.2014 ka vendosur “ Shpalljen e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes civile nr.2187 rregjistri datë 07.06.2013. Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.**

## **GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarës **Bernina Kondi**, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi.

V Ë R Ë N

### *1. Rrethanat e çështjes:*

Nga akti i në detyrën gjyqësore, rezultoi se shoqëria "Hamzaj" shpk, është një shoqëri tregtare e regjistruar në GjK, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e identifikuar me Nr. Nipti-K 36521255 C, e cila ushtron aktivitetin e saj tregtar në fushën e tregtimit me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm, import-eksporti, bar restorante-hoteleri etj. Aktivitet në fushën e prodhimit dhe tregtimit të vajit të ullirit dhe nënprodukteve të tij.

Si rezultat i kontrollit të mbajtur pranë ambjenteve të shoqërisë "Hamzaj" shpk, nga ana e inspektorëve të verifikimit në terren të DRT Vlorë, këta të fundit kanë mbajtur procesverbalin nr.0042599 datë 15.12.2012, në të cilin kanë konstatuar kundërvajtjen administrative të 'mosrespektim të detyrimit ligjor për lëshimin e kuponit tatimor' dhe për këtë shkak bazuar në nenin 122, pika 2/b/ii të ligjit nr.9920/2008, kanë vendosur dënimin e shoqërisë paditëse me gjobë në masën 200.000 lekë. Kjo gjobë i është njoftuar palës paditëse me anë të aktit administrativ, Njoftim vlerësimit tatimor nr.15457 prot datë 31.12.2012 të DRT Vlorë.

Kundër këtij akti administrativ të DRT Vlorë, shoqëria paditëse ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, si hallkë e detyrueshme e parashikuar nga legjislacioni i posacëm për ushtrimin e ankimit administrativ. Drejtoria e Apelit si ka shqyrtuar ankimin me anë të vendimit nr.1837/1 prot datë 07.02.2013 ka vendosur " Lënien në fuqi të njoftim vlerësimit tatimor nr.15457 prot datë 31.12.2012 të DRT Vlorë.

Për sa më sipër, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me padi duke pretenduar shfuqizimin e këtyre dy akteve administrative. Pala paditëse ka pretenduar se nuk ka një akt konstatimi të datës 15.12.2012 të palës së paditur, pasi inspektorët e verifikimit në vend nuk kanë vajtur në vend ushtrimin e aktivitetit të paditësit, procesverbali i konstatimit të shkeljes është mbajtur nga zyra, mungon fakti i pretenduar që vlerësohet si shkelje konform nenit 122/b i ligjit nr.9920/2008. Sipas K.Pr.Administrative, akti administrativ, duhet të parashtrijë qartë faktet dhe duhet të pasqyrojë realitetin se procedura e kontrollit është kryer pa u bazuar në aktet për një njoftim kontrolli. Sa më sipër baza faktike nuk është evidentuar qartazi konform nenit 14 të ligjit nr.10279/2010 'Për kundërvajtjet administrative'.

Pala e paditur ka prapësuar se në momentin e kontrollit nga inspektorët e tatimorë është konstatuar se pala paditëse nuk lëshon kupon tatimor dhe për këtë fakt është mbajtur akt konstatimi datë 15.12.2012, ku dhe është evidentuar fakti se pala paditëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomike nuk lëshon kupon tatimor. Pala paditëse ka shkelur dispozitat e ligjit për procedurat tatimore dhe në këto kushte

njoftim vlerësimi tatimor i DRT Vlorë dhe vendimi i DAT-së. objekt gjykimi kanë akte të nxjerra në bazë e zbatim të ligjit.

## *II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

*Gjykata ka rrëzuar padinë me argumentimin si vijon:*

Në nenin 54 e 55 të ligjit nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”. percaktohet se “tatimpaguesit qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per rregjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin ne menyre te detyrueshme te kuponit tatimor”, pra percakton qarte detyrimin qe ka paditesi te instaloje kasen fiskale dhe te leshoje vetem kuponin tatimor.” Pra ligjevenesit ka percaktuar qarte detyrimin e paditesit per leshimin e detyrueshem te kuponit tatimor per dokumentimin e shitjeve me pakice.

Neni 122 i ligjit nr.9920/2008, në pikën e tij 1/b/i ka përcaktuar se:1) tatimpaguesi person juridik ose fizik tregtar dënohet në rast se ...nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve për çdo rast konstatimi ..b) për kontrollin e parë me gjobë në masën 200.000 lekë për tatimpaguesit e rregjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin dhe gjobë në masën 100.000 lekë për tatimpaguesit e tjerë.

Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr.39/2008 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, i ndryshuar në pikën 4.17 ka parashikuar se “Inspektorët tatimorë kryejnë rregullisht kontrolle për lëshimin e kuponëve tatimorë dhe mbajnë procesverbale, kur konstatojnë shkelje duke vendosur në vend gjobën sipas përcaktimeve ligjore për tatimpaguesit dhe për klientët shkelës të ligjit”.

Ndërkohë që në udhëzimin nr.24/2008, pika 54.3 e tij, është përcaktuar në mënyrë taksative se personat e tatueshëm që shesin mallra për konsum final apo ofrojnë shërbime, në njësi të përhershme të hapura për publikun duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupon tatimor.

Nga aktet e administruara si provë në dosjen gjyqësore rezulton se në zbatim të urdhrin të punës inspektorët e verifikimit në terren të të paditurit kanë ushtruar kontroll pranë palës paditëse dhe kanë mbajtur akt konstatimin nr.021625 datë 15.12.2012, nga ku ka rezultuar se pala paditëse, shoqëria “Hamzaj”shpk, nuk lëshon kupon tatimor. Mbi bazën e këtij akt konstatimi është mbajtur edhe procesverbali i gjobës nr.0042599 datë 15.12.2012, i cili bazohet në nenin 122, pika 1, germa b’ e ligjit 9920/2008, që përcakton penallitet në masën 200.000 lekë, për një shkelje të tillë. Nga pala paditëse

në gjykim nuk u paraqit asnjë provë konkretisht kupon tatimor për xhiron e datës 15.12.2012. datë objekt kontrolli nga pala e paditur, në mënyrë që të provohej e kundërta e asaj sa është pasqyruar në akt konstatimin e datës 15.12.2012.

Sa më sipër gjykata emon se kërkesë padia e ngritur nga pala paditëse, shoqëria "Hamzaj" shpk, duhet rrezuar si e pabazuar në ligj dhe në prova.

### *III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:*

Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo ka kompetencën lëndore dhe funksionale të gjyimit të saj bazuar në nenet 7 dhe 10 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Njehsues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 06.12.2013.

Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Proçedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar aktivisht në padi(paditësi), subjekt ky i legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012(vendimet e paankimueshme).

Në funksion të analizës së shkaqeve të ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.1164 datë 06.05.2013 objekt ankimi, është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat objekt gjykimi.

Gjykata Administrative e Apelit, vëren se sic ka analizuar gjykata e shkalles se pare, konflikti gjyqësor objekt shqyrtimi ka të bëjë me ligjshmërinë ose jo të akteve administrative të të paditurve në gjykim, konkretisht të Njoftim vlerësimi tatimor për detyrimet" nr.15457 prot datë 31.12.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe të vendimit nr.1837/1 prot datë 07.01.2013 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Sic rezulton nga aktet në dosjen gjyqësore si rezultat i kontrollit të mbajtur pranë ambjeteve të shoqërisë "Hamzaj" shpk. nga ana e inspektorëve të verifikimit në terren të DRT Vlorë, këta të fundit kanë mbajtur procesverbalin nr.0042599 datë 15.12.2012. në të cilin kanë konstatuar kundërvajtjen administrative të moslështimit të kuponit tatimor" dhe për këtë shkak bazuar në nenin 122. pika 2/b/ii të ligjit nr.9920/2008. kanë vendosur dënimin e shoqërisë paditëse me gjobë në masën 200.000 lekë

Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson të drejtë sa arsyetuar dhe konkluduar nga Gjykata e Shkallës së Parë, kjo, për faktin se si persona i përket procedurës (*pretendum*) të ngritura në ankim nga pala paditëse)ashu dhe thelbit ka rezultuar e provuar që subjekti paditës të ketë konsumuar kundërvajten administrative të moslëshimit të kuponit tatimor dhe faktit se kjo kundërvajtje është materializuar në akte administrative të nxjerra në përputhje me formën dhe procedurën e parashikuar ligjore.

*Së pari: Sa i takon procedurës së nxjerrjes së njoftim vlerësimeve tatimore.*

Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson të drejtë përfundimin e arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë se aktet administrative, objekt gjykimi janë nxjerre nga ana e organit administrativ, kjo pasi strukturat perkatese të administrates tatimore konform attributeve që u njeh ligji kane ushtruar kontroll dhe kane ndeshkuar paditesin sepse gjate ushtrimit të aktivitetit të tij ka konstatuar kundravajtje administrative per moslëshim të kuponit tatimor, shkelje kjo e parashikuar nga neni 122/1/b i Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar .

Rezulton se Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është organi kompetent i ngarkuar nga ligji që ka të drejtën të nxjerre njoftim vlerësime tatimore, për të mbajtur akt konstatime dhe procesverbale gjore, sipas nenit 69 të ligjit nr.9920, date 19.05.2008 “ Per procedurat tatimore ne RSH” ku përcaktohet se : *1.Drejtoria Rajonale Tatimore nxjerr Njoftim e Vleresimit tatimor per tatimpaguesin e rregjistruar ne administraten tatimore qendrore.*

Po kështu në nenin 68 përcaktohet se: Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit perkates. Vlerësimi bazohet në :

*“a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit*

*b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij Ligji*

*c)menyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji”.*

Paditesi është subjekt i rregjistruar pranë DRT-se, dhe si i tillë në zbatim të nenit 69 kjo e fundit ka të drejtë të nxjerre Njoftim Vlerësime për detyrimet tatimore ndaj paditesit.

Në mbështetje të nenit 68 të Ligjit të procedurave tatimore, DRT-ja ka nxjerre njoftim vlerësimit mbi rezultatet e një kontrolli tatimor. Pra në referim të këtyre dispozitave njoftim vlerësimit tatimor, objekt gjykimi është nxjerre për palën paditëse nga DRT-ja në zbatim të kompetencave të saj ligjore.

Po kështu në nenin 80 është përcaktuar se administrata tatimore kryen kontrolle tatimore duke përcaktuar edhe ato çfare ajo kontrollon. Në pikën 6 të nenit 80 përcaktohet se procedurat për kryerjen e kontrolleve tatimore dhe llojet e kontrolleve tatimore që administrata tatimore kryen në një subjekt tatimpagues ndahen nga Ministri i Financave me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Në Udhezimin e MF nr.24, datë 02.09.2008 “ Per procedurat tatimore në RSH-se” në pikën 80.3 përcaktohet se kontrollet tatimore janë : kontrolle tatimore të plota, vizita fiskale, verifikimet në vend.

Kontrollet tatimore të plota dhe procedurat që ndiqet në kryerjen e tyre janë ato të përcaktuara në nenet 81-85 të ligjit të procedurave ku përcaktohet që tatimpaguesi ka të drejtën të njoftohet me shkrim për kontrollin që do të ushtrohet në të, me programin e kontrollit që përcakton llojet e tatimit që do të kontrollohen, periudhat tatimore për të cilat kryhet kontrolli, datën e kontrollit, vendin e tij, të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit, si kërkesë për të vënë në dispozicion të administratës tatimore informacionin specifik për kontrollin tatimor.

Ndërsa për verifikimet në vend përcaktohet se :

*“ Verifikimet në vend. Keto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me rregjistrimin e personave të tatueshëm ( identifikimin e personave të peregjistruar), me përdorimin e paisjeve fiskale, me përdorimin e pullave të akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe faturave tatimore, etj..”*

Në rastin objekt gjykimi kemi të bëjmë me keto kontrolle pra verifikime në vend ku pala e paditur nuk ka asnjë detyrim ligjor të njoftohet tatimpaguesi që kontrollohet për objektin e kontrollit apo për periudhën kohore që të kontrollohet.

Keto verifikime kryhen pa njoftim paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdherin e dërges, të leshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend. Është e qartë se nëse tatimpaguesi do të njoftohej me parë për objektin e kontrollit që ushtojmë atëherë tatimpaguesit shkeles të ligjit, nuk do të kapeshin në flagrance.

Për sa më sipër, me të drejtë nga gjykata e Shkallës së Parë është çmuar se kontrolli është kryer në përputhje me keto dispozita procedurale.

Së dyti: Sa i takon thelbit të shkeljes të konstatuar nga i padituri DRT-Vlorë.

Sa i takon bazueshmërisë në ligj e prova të njoftim vlerësimit tatimor, objekt gjykimi për të cilin paditësi është penalizuar me gjobë në masën 200.000 lekë, me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se penalizimi i shoqërisë paditëse është ndërmarrë gjatë kontrollit, për të cilin administrata tatimore e ka penalizuar atë me gjobë në masën 200.000 lekë në referim të nenit 122 pika 1, germa “b” “f” të Ligjit

nr.9920 date 19.05.2008 ~ Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i cili parashikon se: *“Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se: li për kontrollin e parë, me gjohë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin dhe gjohë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë.”*

Më tej referuar edhe Udhezimit m.39, dt.09.12.2008 “ Per administrimin dhe dokumenimin e procedurave te paisjes fiskale“ , ne pikën 4.17 te tij parashikohet se : *“ Inspektoret tatimore kryejne rregullisht kontrole per leshimin e kuponave tatimore dhe mbajne procesverbale kur konstatojne shkelje duke vendosur ne vend gjoben sipas percaktimeve ligjore, per tatimpaguesit shkeles te ligjit.”*

Ne nenin 54 e 55 te ligjit nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, percaktohet se “tatimpaguesit qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per rregjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin ne menyre te detyrueshme te kuponit tatimor”, pra percakton qarte detyrimin qe ka paditesi te instaloje kasen fiskale dhe te leshoje vetem kuponin tatimor.”

Pra ligjevenesi ka percaktuar qarte detyrimin e paditesit per leshimin e detyrueshem te kuponit tatimor per dokumentimin e shitjeve me pakice., detyrim ligjor i cili nuk rezulton të jetë zbatuar në rastin konkret. Për më tepër Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se pala e paditur, në mbajtjen e akt konstatimit dhe procesverbalit të gjobës në të cilët është konstatuar shkelja, të ketë respektuar kërkesat ligjore të neneve 13 dhe 14 të ligjit nr.10279/2010 “Për Kundërvajtjet administrative” që kanë të bëjnë me mënyrën e mbajtjes së procesverbalit deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar pas konstatimit të shkeljes.

Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim nga pala paditëse referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ato janë të pabazuara në ligj e prova. Në këto pretendime rezulton të jenë paraqitur të njëjtat fakte dhe argumenta që janë paraqitur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe asnjë argument shtesë përse analiza e rrethanave të faktit të bërë në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është e pabazuar në ligj e prova.

Konstatohet se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim nga pala paditëse, u është dhënë zgjidhje në vendim nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit që janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analizë rezulton të jetë plotësisht e bazuar në kriteret e dispozitave përkatëse të përmendura në vendim.

Gjykata Administrative e Apelit nuk gjon dhe/or ligjore për të cënuar vendimarrjet e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe për këtë arsye bazuar në nenin 50, shkronja "b" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshur, përfundimisht vlerëson se vendimi nr. 1164 datë 06.05.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë duhet të nënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja "b" e ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

### **VENDOSI :**

- Lënien në fuqi të vendimit nr.1164, datë 06.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

**-Tiranë, më 15.06.2016**

**GJYQTARE**

**Altina NASUFI**  
d.v

**GJYQTARE**

**Bernina KONDI**  
d.v

**GJYQTAR**

**Kastriot SELITA**  
d.v

**Vertetohet njesia me origjinalin**  
**KANCELAR**  
**Leonard Strataj**